



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.32.6a-2014-08

RAPORT I AUDITIMIT
PËR PROJEKTIN "RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË
GORANCË DHE PALDENICË' - HANI I ELEZIT

Auditimi sipas marrëveshjes me UN Habitat No. 09/2013

Prishtinë, Gusht 2015

1 Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), sipas marrëveshjes me UN HABITAT të datës 10 dhjetor 2013, ka kryer auditimin final të raportit financiar për projektin “Rregullimi i hapësirave publike në Gorancë dhe Paldenicë” në Han të Elezit.

Më 08.07.2014 Komuna e Hanit të Elezit ka lidhur marrëveshje me UN Habitat-in që të financojnë bashkërisht këtë projekt, ku 63% e financon Komuna e Hanit të Elezit dhe 37% UN Habitat-i.

2 Fushëveprimi

Është përgjegjësi e palëve të përgatisin raportin financiar. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është kontraktuar që të kryejë auditimin e raportit final financiar si dhe ekzaminimin fizik nëse punët janë kryer sipas marrëveshjes.

3 Realizimi i projektit

Përshkrimi

Procedurat e prokurimit ishin zhvilluar nga Komuna. Tenderi ishte zhvilluar me procedurë të hapur dhe kriter për dhënien e kontratës ishte çmimi më i ulët. Më 25.09.2014 ishte lidhur kontrata me operatorin ekonomik SHPK ‘EL-BAU’. Vlera e kontratës ishte 79,870€.

Komuna kishte caktuar organin mbikëqyrës, të përbërë nga tre zyrtarë, për pranimin e punëve sipas situacioneve. Projekti ka përfunduar sipas kontratës dhe më 27.01.2015 dhe punimet ishin pranuar nga komisioni i pranimit.

Deri në kohën e auditimit, Komuna e Hanit të Elezit kishte kryer në tërësi obligimin sipas marrëveshjes për financimin e projektit, duke paguar 50,285€. UN-Habitat-i ka paguar shumën prej 20,555€ dhe ka obligim financiar ndaj ShPK “EL-BAU” shumën 4,949€.

Konkluzion

Projekti ka përfunduar në tërësi dhe është realizuar sipas marrëveshjes dhe standardeve të kërkuara teknike si dhe me cilësi të mjaftueshme. Projekti ka kontribuar në arritjen e objektivave gjithëpërfshirëse dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Tabela 1. Pasqyra e pagesave (në €):

Bashkëfinancuesi:	Obligimi:	TVSH	Të paguara:	Borxhi i mbetur:
Komuna	50,285	6,934	50,285	0
UN-HABITAT	29,585	3,289 ¹	20,555	4,949
Totali	79,870	10,223	70,570	4,949

Rekomandojmë menaxhmentin e UN-HABITAT që :

- Të paguajë situacionin e fundit në vlerë 4,949€; dhe
- T'i lëshojë ShPK "EL-BAU" konfirmimin për lirim nga pagesa e TVSH.

¹ Në pajtim me ligjin, UN-Habitat është i liruar nga pagesa e TVSH-së.